



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:253780

Datë: 23.07.2024

Numri i dokumentit: 05967934

P.nr.441/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit G.L nga fsh....-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1902-4/19 të datës 30.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.17.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Sadat Topalli dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av. N. R., në mungesë të përfaqësuesit të dëmtuarës, me dt.22.07.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt. 23.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri G.L nga fsh....-Kaçanik, i lindur më dt....., nga i ati M... dhe e ëma R..., e gjinisë Z..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind I tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, I punësuar në kompaninë “...” në Ferizaj, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me date 20.08.2019 rreth ores 20:45 min, në pyllin e mbrojtur, Pjesë e Parkut Kombëtar “Sharri” , njësinë menaxhuese Jasikë, ne vendin e quajtur “te stanet e Doganajve, i pandehuri me qëllim të vjedhjes së drunjve, ka prerë me sharrë motorrike një dru të llojit të ahut, me diametër 40 cm, lartësi 22 m. dhe vellim te pergjithshem prej 0.88 m3, me të cilin rast të dëmtuarës, Agjencise së Kosoves për Mbrojtjen e Mjedisit i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 264.00 € .

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 3 nënpar.3.1 lidhur me 3.2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,44,69,70, 71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqind euro) dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditë.

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, konfor nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 450.00 (katërqind e pesëdhjetë euro)

I pandehuri është i obliguar qe dënimin me gjobë t’a paguaje brenda afatit prej 30 ditesh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në 3 këste mujore.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t’a zëvendesojë dënimin me gjobë, me dënim me burgim, duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 50,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave te Krimit ne shume prej 20.00€, te gjitha keto paguhen pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prerë, në afat te njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara, Agjensia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit-MMPH Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1902-4/19 të datës 30.10.2019, të pandehurin G.L nga fsh...-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.11.05.2023 me te cilin rast, I pandehuri, pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori I shtetit, nuk e ka pranuar plotësisht fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqesor të mbajtur më 17.07.2024, prokurori I shtetit Sadat Topalli, me rastin e prezentimit të aktakuzës, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, përmes një parashtrëse me shkrim, e ka njoftuar gjykatën se e mbështet aktakuzën e prokurorit të shtetit, ndërsa sa I përket kërkesës pasurore juridike, ka kërkuar nga Gjykata që për të njëjtën e dëmtuara të udhëzohet në contest civil.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqesor, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shtuar se ishte gjendja e vështirë ekonomike ajo që në atë kohë e kishte shtyrë për të ndërmarrë këtë veprim, megjithatë edhe përkundër kësaj e ndien veten të penduar për veprimin e tij dhe I premtonte gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe I kërkon gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit t’I shqiptohet një denim sa më të ulët që të jetë e mundur, meqë edhe ashtu tani është I punësuar dhe nuk është I ineteresuar për këto veprime.

Prokurori i shtetit ne fjalën e tij nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit meqë i pandehuri e kuptoi natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë

në mënyrë vullnetare nga i pandehuri, pranimi i fajësisë gjithashtu ka mbështetje në faktet dhe provat që i përmban aktakuza si dhe gjithashtu aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Prandaj i propozon gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Në fjalën e tij përfundimtare, prokurori I shtetit deklaroi se, nga vetë pranimi I fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili vullnetarisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv. Andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë rënduese shkallën e lartë të pjesëmarrjes në veprën penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese lehtësuese, të marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit .

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, poashtu e ka mbështetur pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, meqë pranimi I fajësisë është bërë konform dispozitave të KPP-së, pranda edhe I ka propozuar gjykatës që t'a miratojë këtë pranim fajësie. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se, meqë i mbrojturi I tij e ka pranuar fajësinë në këtë fazë të procedurës penale, I propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese ligjore duke përfshirë, pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, pendimin e tij të sinqertë, faktin se për natyrë të njëjtë të veprës penale ka mbajtur 11 muaj burgim dhe tani nuk e ka asnjë vepër penale. Andaj i propozon gjykatës, që të mbrojturit të tij shqiptojë një dënim me kusht, marrë parasysh faktin se gati një vit nuk ka mundur të punojë me qenëse është mbajtës i vetëm i familjes, andaj në rastin konkret konsideron se dënimi me kusht përveq se do të ishte preventivë për të mbrojturin të tij, në të njëjtën kohë nuk do të rrezikonte edhe me tej gjendjen ekonomike të të mbrojturit të tij e cila gjendje veq se është e dobët .

Fjalën përfundimtare të mbrojtësit e ka mbështetur në tërësi edhe I pandehuri.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 322 lidhur me 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike andaj shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor duke premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, dhe faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës, I njejtë që nga viti 2019 nuk ka të regjistruar lëndë të kësaj natyre, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti, se, bazuar në evidencën penale, certifikata e të cilit I është bashkangjitur shkresave të lëndës, I njejtë, ka patur edhe dy raste tjera penale për vepër penale të njejtë për të cilat është gjykuar me aktgjykim të plotëfuqishëm dhe atë aktgjykimi P.nr.391/2014 I dt.29.08.2018 për veprën penale, Vjedhje pylli nga neni 358 të KPRK-së, me të cilin është gjykuar me dënim me burgim dhe aktgjykimi nr.2019:243878 I dt.29.08.2018 për vepër penale në bashkryerje, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, për të cilën është gjykuar me dënim me kusht.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin G. L., i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK

P.nr.441/19 datë 23.07.2024

Sekretarja juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.